



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401047/8

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandohet marrja e masave për ekzekutimin në një kohë sa më të shkurtër të vendimeve të formës së prerë të gjykatës që caktojnë masë sigurie "arrest me burg" dhe dënim me burg*

Drejtuar: **Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve**
Z. Artur ZOTO

TIRANË

I nderuar Z. Zoto,

Institucioni i Avokatit të Popullit, nisur nga disa ankesa të paraqitura pranë tij, kreu një hetim lidhur me vonesat në transferimin në IEVP të personave ndaj të cilëve është caktuar masë sigurie "arrest me burg" dhe të ndaluarve të dënuar me një vendim me burgim të formës së prerë. Për verifikimin e situatës u kryen inspektime në disa komisariate të Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë si dhe u mbledhën të dhëna nga Policia e Shtetit. Nga informacioni i mbledhur rezultoi se, personat me masë sigurie "arrest me burg" nuk pranohen në kohë nga IEVP-të për shkak të mbipopullimit të tyre. Ndërsa për personat e ndaluar, të dënuar me vendim me burgim të formës së prerë, ka gjithashtu vonesa në transferimin e tyre në IEVP për shkak të zgjatjes së procedurave për caktimin e institucionit ku ata do të vuajnë dënimin. Prej Muajit Dhjetor 2013, situata ka qenë veçanërisht e rënduar në komisaritet e policisë në Drejtorinë e Policisë të Qarkut Tiranë.

Referuar neneve 21, 22, 23 49 dhe 50 të Ligjit Nr. 8331, datë 21.04.1998 "Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale", vendimet penale që përmbajnë burgim dhe miratim të kërkesës së prokurorit për masën e sigurisë, ekzekutohen menjëherë me urdhër të gjykatës pas shpalljes së vendimit. Mbi bazën e vendimit të gjykatës, prokurori nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve saktëson institucionin ku i dënuari do të vuajë dënimin. Ekzekutimi i këtyre vendimeve penale duhet të bëhet brenda 48 orëve.

Dhomat e sigurisë në komisaritet e Policisë së Shtetit nuk kanë kushte për të mbajtur për një kohë të gjatë persona të ndaluar/arrestuar. Gjithashtu mos transferimi në kohë i të dënuarve dhe paraburgosurve në ambjentet e IEVP-ve, i privon ata nga përfitimi i disa të drejtave që burojnë nga Ligji "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".

Për sa më lart, bazuar në Nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut” si dhe në mbështetje të Nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” (me ndryshimet përkatëse) ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”

J U R E K O M A N D O J M Ë:

Marrjen e masave për ekzekutimin në një kohë sa më të shkurtër të vendimeve të formës së prerë të gjykatës që caktojnë masë sigurie “arrest me burg” dhe dënim me burg.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI